

KONTRATË
MBI "THEMELIMIN E SHOQËRISE SË THJESHTË"
" ONE STOP TOBACCO SHOP "

Sot, me datë **08/05/2023**, në Shkodër, Shqipëri, personi i mëposhtëm:

Z. Geraldo Guri, shtetas shqiptar, lindur më **14/01/1996** lindur ne Benë dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J60114065J**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe

Znj. Marjeta Guri, shtetas shqiptare, lindur më **20/05/1974** lindur ne Karmë dhe banuese në Shkodër, mbajtëse e letërnjoftimit me numër **H45520211C**, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe

Znj. Agetina Guri, shtetase shqiptare, lindur më **14/10/1998** lindur në Benë dhe banuese në Shkodër, mbajtëse e letërnjoftimit me numër **J86014067N**, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosën të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqiperisë dhe me dispozitat në vijim:

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anetarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Emri i shoqërisë së thjeshtë është "**ONE STOP TOBACCO SHOP**", këtu e më poshtë e quajtur "**Shoqëria**".

Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.



NENI 2
Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: Gjuhadol, ndertesa nr 57, H 3, zona kadastrale 8593, 4001 Shkoder

Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

NENI 3
Veprimtaria

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë;

Shitje me pakicë të artikujve të ndryshëm, pije freskuese dhe alkolike, tobacco shop.

NENI 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

NENI 5
Kapitali Themelor dhe Ortakët

Kapitali i Shoqërisë është 300.000 Lekë (treqind mijë).

Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportin e mëposhtëm;

-nga Z. Geraldo Guri, 34% e kapitalit, me 1 kuotë, Kapitali I hedhur: 102000 lekë,

AG



- nga Znj. Marjeta Guri, 33% e kapitalit, me 1 kuotë, Kapitali I hedhur: 99.000 lekë,
- nga Znj. Agetina Guri, 33% e kapitalit, me 1 kuotë, Kapitali I hedhur: 99.000 lekë.

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.

NENI 6

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime. Ne kete rast Asambleja perbehet nga ortaket e shoqerise, Geraldo Guri, Marjeta Guri dhe Agetina Guri.

NENI 7

Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Znj. Agetina Guri, shtetase shqiptare, lindur më **14/10/1998** lindur në Benë dhe banuese në Shkodër, mbajtëse e letërnjoftimit me numër **J86014067N**, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Mandati i Administratorit është për një periudhe prej 5 (pesë) vitesh, nga Data 08.05.2023 – 08.05.2028. Pozicioni është i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



NENI 8
Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet ne fuqi.


Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor 2023.

NENI 9
Të ndryshme

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

ORTAKET E SHOQËRISË:

AGETINA GURI

Agetina Guri


GERALDO GURI

Geraldo Guri


MARJETA GURI

Marjeta Guri
